



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 27 maj 2020, në mbledhjen e XXII-të (njëzet e dytë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 11:35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu ndërsa munguan Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Arbresha Bashota zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë, Fadil Babatinca, përfaqësues nga Policia e Kosovës (Stacioni Podujevë), Gergina Kovacs dhe Lasla Siklosi, përfaqësues nga KFOR.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu uruar mirëseardhje pas situatës së krijuar nga Pandemi Covid-19 si duke iu dëshiruar shëndet të mirë për të gjithë dhe shtoi, thirrjen dhe materialin e rendit të ditës e keni marrë me kohë, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Komunitete mbajtur më 06 mars 2020

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim-ndryshim u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 mars 2020

2. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes emergjente në territorin e Komunës së Podujevës pas përhapjes së Pandemisë Covid-19, si dhe rreth gjendjes së Qytetarëve të Komunës së Podujevës, me theks atyre të Komuniteteve jo shumicë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, lidhur me gjendjen socio ekonomike të komunitetit Rom, Ashkalinj dhe Egjiptas - RAE gjatë kohës së pandemisë për më shumë informata e ftoj përfaqësuesen e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS ta merr fjalën dhe ta na informoj më në detaje.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, lidhur me menaxhimin e situatës emergjente gjatë pandemisë ne kemi punuar vazhdimisht madje edhe në ditët e vikendeve dhe festave zyrtare, duke mos përjashtuar edhe punën që kemi bërë si Drejtori edhe pas orarit të punës vetëm e vetëm që punët dhe aktivitete tona të kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Lidhur me ndihmat e ofruara nga donatorët, kemi pasur shumë donatorë të cilët kanë ndihmuar me pako ushqimore dhe miell, për familjet që janë raste sociale dhe për familjet të cilat kanë pasur nevojë për ndihmë ku disa prej tyre nuk kanë qenë raste sociale por që anëtarët e tyre kanë mbetur pa punë për shkak të mbylljes së bizneseve dhe veprimtarive tjera përkatëse e që rrjedhimisht kanë mbetur pa të hyra. Përzgjedhjen e këtyre familjeve e kemi bërë me ndihmën e Qendrës për Punë Sociale sipas kërkesave të tyre që u janë drejtuar Komunës nga vet anëtarët e atyre familjeve, pastaj ka pasur kërkesa të cilat kanë ardhur nga përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve të qytetit. Ne jemi munduar që të mos bëjmë dallime as politike dhe as në aspektin e komuniteteve por jemi munduar që t'i përfshijmë të gjithë ata që kanë pasur nevojë.

Unë personalisht kam qenë pjesë e ndarjes dhe pjesë e bashkëpunimit të përgatitjes së listave si dhe pjesë e shpërndarjes së pakove. Komuna ka ndarë 2280 pako në të cilat ka pas miell dhe gjëra ushqimore, e që për mendimin tim kanë qenë pako mjaft të mira, gjithashtu edhe nga UNMIK si donatorë janë dhuruar pako ushqimore dhe higjienike (40 pako ushqimore, 40 pako higjienike) të cilat pastaj në bashkëpunim me neve si Komunë janë bërë bashkë/kombinuar duke shtuar edhe 10 pako të plota nga ana e Komunës dhe në fund u janë shpërndarë 50 familjeve. Listat janë përgatitur nga përfaqësuesit e komuniteteve por edhe për ato raste të cilat për neve janë të njohura më herët për ne. Mandej kemi pasur ndihma nga shoqata të ndryshme si (Islamic Roles, Shoqata Hummanity, Shoqata Besa, Festimi Tours, ETC, Qattar Qarity).

Lidhur me shpërndarjen e pakove familjeve të Komunitetit jo shumicë ne i kemi dërguar edhe nëpër lokacionet e tyre, shembull, në rrugët "Ali Ajeti", "Xhafer Meta", pastaj në fshatrat Orllan dhe Batllavë, e që shumica e familjeve sipas listave janë përzgjedhur nga vet përfaqësuesit e atyre lagjeve apo fshatrave. Natyrisht se jemi munduar të përfshijmë sa më shumë familje sepse e dimë gjendjen e tyre sociale dhe janë mbetur pa punë. Pra mund të themi se jemi munduar që të bëjmë maksimumin për t'i përfshirë të gjithë për t'iu ndarë ndihma, por që numri i përfituesve të familjeve të komunitetit jo shumicë nga Komuna janë 110, ndërsa numri i përfituesve të komuniteteve nga donatorët është rreth 115 - 120 familje.

z.Bashkim Syla, parashtroi pyetje për parafolësen, theksoi, u tha se numri i përfituesve të komuniteteve nga Komuna është 110 familje, ndërsa nga donatorët rreth 115-120 familje e që në total i bie rreth 225 familje të komunitetit jo shumicë që paskan qen përfituese të ndihmave me pako në fjalë, andaj pyetja është, a mund të na tregoni edhe sa familje tjera nga komuniteti RAE nuk kanë marrë pako ushqimore dhe higjienike, si dhe sa ka përmbajtur gjëra ushqimore kjo

pako për një familje dhe a kanë qenë të njëjta pakot ushqimore të Komunës me ato të donatorëve, apo kanë qenë të ndryshme.

znj.Arbresha Bashota, përgjigje parafolësit, theksoi, pakot kanë qenë të ndryshme me artikuj të ndryshëm, afërsisht kosto ka qenë e njëjtë rreth 50-60 € vlerë, ka pasë artikuj të ndryshëm, nuk kanë qenë të gjitha pakot të ngjashme, shembull, pakoja e UNMIK-ut nuk ka qenë e njëjtë me atë të Komunës, mirëpo përafërsisht artikujt kanë qenë të ndryshëm, nëse nuk gaboje diçka njëra pako ushqimore ka përmbajtur 4 shishe vaj, tjetra 6 shishe, mandej sheqeri apo disa artikuj tjerë kanë qenë më shumë ose më pak, por përafërsisht pakot ushqimore kanë qenë në vlerën që e ceka.

Sa i përket numrit të familjeve të komuniteteve jo shumicë të cilat nuk kanë qenë përfituese, nuk kam informata që tani të jap numër, por ajo që mund ta them është se jemi munduar që t'i përfshijmë të gjitha familjet të cilat kanë pasur nevojë sidomos familjet nga komuniteti RAE ngase jemi në dijeni për gjendjen e tyre.

znj.Doruntina Hasani, duke dëshiruar që të gjithë jemi mirë dhe ta kemi kaluar këtë periudhë të vështirë, theksoi, sa i përket informatës në fjalë do të dëshiroja që këto informata të cilat vazhdimisht po paraqiten kështu drejtpërdrejt, të sillleshin në formë të shkruar së bashku me materialin e mbledhjes, andaj herëve tjera nëse ka mundësi të dërgohen me e-mail, në mënyrë që të kemi mundësi t'i analizojmë. Sa i përket pakos besoj se pakot e Komunës kanë shkruar njëjtë si pakot tjerat, meqenëse ato familje kanë përfituar ashtu, një falënderim për Komunën, pothuajse janë përfshirë familjet e komuniteteve jo shumicë, një pjesë e tyre më kanë njoftuar përmes rrjeteve sociale se janë ndihmuar, por që ndoshta është dashur që më herët të veprohet me ato familje për shkak se kanë qenë në gjendje shumë të vështirë ekonomike.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, lidhur me gjendjen socio ekonomike të komunitetit RAE gjatë kohës së pandemisë pyet përfaqësuesen e drejtorisë përkatëse zonjën Arbresha Bashota. Pakot ushqimore dhe higjienike që i keni shpërndarë gjatë kësaj periudhe në Komunitetin RAE dhe në të dy lagjet sa i përket , pajisjet mbrojtëse si doreza, maska, dezinfektues a janë ndarë këto në Komunitetin RAE, edhe a ka pasur kërkesa për diçka të tillë.

znj.Arbresha Bashota ndër të tjera theksoi se nuk kam informacion për kërkesa të tilla.

z.Liman Zeqiri ndër të tjera theksoi mbledhja e parafundit me datë 06.03.2020, dmth kanë kaluar tre (3) muaj që nuk jemi takuar, për hir të një situatë që kaploi botën, diçka e jashtëzakonshme e pa imagjinuar diçka interesante sikur nëpër filma ta quaj, u ballafaquam edhe ne si pjesë e globit me këtë pandemi, edhe shtetet më të fuqishme botërore u gjinden para një situatë pandemie të vështirë duke përfshirë Amerikën edhe shtetet më të fuqishme evropiane, nuk munden ta menaxhojnë mirë këtë situatë si diçka e jashtë zakonshme. Unë e them këtë në kuptimin e asaj në qoftë se i referohem, ne si shtet si Kosovë duhet ti falënderojmë të gjitha institucionet qofshin lokale dhe qendrore, qoftë qeverinë qoftë ministria për shëndetësi, në kuadër të qeverisë, qoftë edhe institucionet lokale dhe gjithë akterët tjerë, dhe një falënderim të jashtëzakonshëm edhe për shërbimet që kanë qenë gardian do ti quaj të gjithë ata në shërbimin shëndetësor policor, zjarrfikësve vetëdijesimin e lartë të qytetarëve që kanë kuptuar diçka që nuk ka ndodhur kurrë më parë në ballafaqime të tilla kur është gjendje e jashtëzakonshme atëherë njerëzit mobilizohen edhe vullnetar përpos institucioneve. Institucionet për mua e kanë një vlerësim të lartë, që sot jemi në këtë gjendje stabile ta quaj, dhe të takohemi sot që nuk e kanë ditur dhe nuk e kemi ditur që mund të takohemi edhe në situata të tilla. Komuna jonë me 13.03.2020, e ka formuar shtabin emergjent dmth shtabin emergjent që është përgatitur si është përhapur kjo pandemi në Itali dhe në vendet tjera evropiane, e kemi ditur që është diçka që edhe neve na ndodhë, dhe në kuadër të asaj me kapacitetet e veta që ka pasë institucionale duke falënderuar kryetarin dhe drejtoritë, jemi ardhurë në një gjendje të një mobilizimi ta quaj dhe

dihet se rasti i parë me Covid 19 është shfaqur në Komunën e Podujevës, në Llap , në fshatin Dumnice dhe ka qenë vdekja e parë nga Covid 19. Me menaxhimin tonë si komunë si institucione dhe me vetëdijesimin e qytetarëve, Komuna jonë ka territorin më të madh në nivel vendi me 78 fshatra e më shumë se njëqind mijë(100.000) banorë është një mrekulli e Zotit që ne kemi pasur vetëm nëntë (9)raste me Covid 19 dhe një vdekje dhe ajo vdekje ka qenë e një personi të moshuar. Shtabi emergjent ka punuar në të gjitha drejtimet së pari duhet të urojmë në atë kuptimin shëndetësor që shëndeti primar mbi të gjitha, por është edhe ajo ana ekonomike pasi jemi ne për Komunitete është normale që me të gjitha mundësitë tona si komunë, si donatorë si donacion, që ende vazhdon jemi munduar që ta përballojmë. Por edhe shteti si shtet duhet ta kuptojmë edhe qeveria me të gjitha mundësitë e veta që i ka pasë edhe me fondet e veta është munduar me menaxhuar situatën, nuk mundemi të japim vetëm kritika është mirë nganjëherë të dalim edhe kah anët pozitive, duke krahasuar vendin tonë me shtetet më të fuqishme që s'kanë mundur ta menaxhojnë situatën me pandeminë Covid -19. Unë nuk kam kritika mirëpo kam falënderime edhe për komunën edhe për qeverinë, dhe për të gjithë qytetarët që jemi gjend në këtë gjendje, ta ndihmojmë njëri tjetrin me ato mundësi që kemi. Ne e dimë që Komuna së pari ka pasë një buxhet të vogël prej dhjetë mijë (10.000) Euro, pastaj e ka shtuar në një buxhet prej njëqind e njëzet e pesë mijë (125.000) Euro për këtë situat emergjente dhe për pakot ushqimore. Unë kam pasur kontakte me të rregullta me të gjithë përfaqësuesit e lagjeve të Komuniteteve RAE qoftë në Rr. “Ali Ajeti”, qoftë në Rr. “Xhafer Meta”, qoftë në Orllan,në Batllavë, në Sfeçël, por edhe me kryesuesen që është këtu për ti ndihmuar të gjithë ata që kanë pasur nevojë që kanë mundur të lajmërohen te përfaqësuesi qoftë me listë apo edhe në mënyrë individuale, faleminderit edhe prej të gjithë atyre donatorëve që kanë shfaq mirëkuptim mirësjellje dhe kanë kontribuar për këtë situatë emergjente por edhe komuna si komunë deh sa do ku do e kemi menaxhuar këtë situatë të rëndë që e kemi pasë dhe dashtë Zoti, mos të përsëritet më dhe dashtë Zoti, për të gjithë njerëzimin që të kemi shëndet, të kemi jetë të kemi fat, të kemi lumturi, të kemi perspektiv se ka qenë një tronditje globale që edhe ne na ka gjetur në këtë situatë, por megjithatë me aktivitetin tonë, me mundësitë tona, me kapacitetet tona, shëndetësore, ekonomike, politike, kemi ardhur deri te një sanim por prap kjo është një luftë, është fituar një betejë sot jemi më të lirë kjo ende vazhdon ,normale që shtetet më të fuqishme nuk kanë thënë që pandemia ka përfunduar, nuk e dimë se sa zgjatë kjo pandemi pe e quaj me një fjalë armik i pa dukshëm dhe e përjetuam po ende si komunë për çdo rast që është në gjendje të rëndë ekonomike mund të lajmërohet te drejtoria përkatëse, janë edhe sektorët që ti ndihmojmë se nuk ka përfunduar kjo, tani problemi më i madh është ai ekonomik përpos pandemisë që ka me krijuar shumë pasoja, shumë biznese janë mbyllur shumë njerëz nuk mund të punojnë edhe pse kanë punuar sidomos në kuadër të Komuniteteve RAE, normale që s'ka pasur punë s'ka pasur aktivitete, s'ka mundësi dhe nuk mundet njeriu me jetuar parazit me disa ndihma, por duhet të mendojmë dhe të menaxhojmë, si të vijmë te rimëkëmbja e ekonomisë, krijimi i vendeve të reja të punës, menaxhimi i situatave dhe zhvillimi që njerëzit të mund të jetojnë, se ky vit është shumë vit i rëndë, qoftë në arsim qoftë në shëndetësi, qoftë në punësim është viti më i rëndë i këtij shekulli që është problem me u sanuar, normale që pa dëshirën tonë kemi ardhur në këtë situatë. Ne jemi në gjendje të ju ndihmojmë me ato mundësi që kemi si Komunë. Pa kritika të rënda se jemi gjet në një sfidë që edhe ne nuk kemi ditur ta menaxhojmë, dashtë Zoti që të jetë pikë së pari shëndeti në familjet tona dhe të juaja,dhe të gjithë qytetarëve dhe i gjithë njerëzimi të jenë mirë, vdekje më pak shëndet më shumë, lumturi punë dhe mirëqenje për të gjithë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, lidhur me gjendjen socio ekonomike të komunitetit RAE gjatë kohës së pandemisë njoftoi se përfaqësuesi i OSBE-së Z.Bekim Karagjiu nuk ka

mundur të marrë pjesë në mbledhje për shkak zyra e OSBE-së nuk i ka lejuar të marrin pjesë në mbledhje të tilla.

3. Të ndryshme

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, lidhur me gjendjen socio ekonomike të komunitetit RAE gjatë kohës së pandemisë njoftoi se nxënësit e Komunitetit RAE në Komunën e Podujevës se ka pasur vështirësi në kyçjen e mësimeve online për shkak të mungesës së pajisjeve, mandej edhe disa kërkesa tjera si përkrahjen me bursa ndërtimin e disa shtëpive rinovimin etj.

Z.Bashkim Sylja kërkon që në mbledhjen e radhës nga drejtoria e arsimit mbarëvajtjen e mësimit nga ana e Komunitetit RAE.

z.Liman Zeqiri ndër të tjera theksoi që në mbledhjen e ardhme të jetë një pikë e rendit të ditës, dhe mendoj që të jetë java e parë e qershorit, si dhe mbledhjet e humbura ti kompensojmë, ato mbledhje të humbura situata ka qenë e tillë, dhe mendoj që javën e parë të qershorit me pasë një pikë të veçantë, dhe për përkrahjen e njerëzve me nevojë , për arsim qoftë me bursa qoftë me mjete tjera unë kam kontakte me drejtorin e Arsimit kemi informacione që teknologjia është një kosto e veçantë dhe shumë familje nuk kanë mundur përballojnë përpos atyre që RTK-ja i ka transmetuar mësimet online, pajtohem me Bashkimin që mbledhjen e ardhme Drejtoria e Arsimit të na informoi për gjendjen reale.

znj.Doruntina Hasani kërkoj që të dalim në vizitë në terren te Komuniteti RAE për të parë gjendjen së çka nevojitet që me marrë informacione se e dimë që për shkak të pandemisë Covid 19 në për shkak të ndaljes së projekteve në komunë ka me tepër buxhet dhe mundemi me kërku që nga një pjesë e buxhetit të iu ndihmojmë në çfarëdo mënyre që mundemi do të kërkojmë edhe në kuvendin komunal.

Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0023648/20
Podujevë,
27 maj 2020

Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu